



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110 – 78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon :

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 8, 12, 13 ,15 deri në 16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.2008 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit Lipjanit 15Nr. 110 – 78095 i datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës _____2026, miratoi këtë:

PROPOZIM

RREGULLORE
PËR TAKSAT DHE GJOBAT KOMUNALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores për taksat dhe gjobat komunale (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vetanake buxhetore në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal si dhe përcaktimi i gjobave apo sanksioneve kundërvajtëse për rastet e shkeljeve të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

M

Neni 2 Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohen taksat komunale nga kompetenca e komunës, obliguesit, procedura e pagesave si dhe procedura e ankesave, si vijon:

1. Taksat administrative për lëshimin e dokumenteve zyrtare ,
2. Taksa për pronësinë e automjeteve motorike,
3. Taksa për vendosjen e objekteve lëvizëse në sipërfaqet publike,
4. Taksa për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Taksa për rendin e udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus,
6. Taksa për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë auto-taksi,
7. Taksat për shfrytëzimin e parkingjeve për automjete taksi,
8. Taksa për antena të telefonisë mobile dhe të internetit,
9. Taksa për përçojat e vendosura në pronën komunale,
10. Taksa për dhënien e pëlqimit për kyqje në rrugë publike,
11. Taksa për dhënien e pëlqimit për ndëprerje të përkohëshme të qarkullimit në rrugën publike,
12. Taksa për dhënien e pëlqimit për shpim, prerje të rrugës publike dhe trotuarit me asfalt dhe kubëza,
13. Taksa për shfrytëzim të trotuarit për shkarkim të mallrave dhe gjësendeve tjera,
14. Taksë për shfrytëzimin e hapësirave publike rreth venpunishteve,
15. Taksë për shfrytëzimin e parkingjeve publike,
16. Taksat për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për rastet e veçanta për realizimin e investimeve në sektorin e energjisë,
17. Taksat për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës (përcaktimi i qirasë).

Neni 3 Taksat tjera dhe bashkëpagesat

1. Taksat administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore do të përcaktohen me vendim të veçantë, në pajtim me procedurat e parapara me nenin 22 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.18 e datës 03.07.2012 dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj.
2. Taksat tjera të përcaktuara me dispozita ligjore, bashkëpagesat për arsim dhe shëndetësi, tarifrat për shërbimet dhe produktet kadastrale, taksat për regjistrimin e të drejtave në pronën e paluajtshme, të cilat sipas kompetencës i përcaktojnë Ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të aplikohen nga organet e Komunës në pajtim të dispozitave ligjore dhe udhëzimeve përkatëse administrative.

Neni 4
Fushëveprimi

Taksat e përcaktuara me këtë rregullore i zbatojnë organet e administratës dhe institucionet tjera komunale, nëse me dispozita ligjore nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 5
Obliguesit

Obligues për pagesën e taksave të përcaktuara me këtë rregullore janë personat fizik dhe juridik me rastin e parashtrimit dhe zgjidhjes së kërkesave të tyre nga fushëveprimi i organeve të administratës dhe institucioneve të Komunës.

II. TAKSAT

Neni 6
Taksat administrative për lëshimin e dokumenteve zyrtare

1. Këto taksa i aplikojnë organet e administratës dhe institucionet e Komunës me rastin e parashtrimit të kërkesave të personave fizik dhe juridik për lëshimin e dokumenteve zyrtare, si në tabelën në vijim:

Nr	EMËRTIMI I DOKUMENTIT	SHUMA
1	Ekstrakt nga regjistri qëndror i gjendjes civile, certifikatë e lindjes, , certifikata e martesës , certifikata e vdekjes, certifikata e vendbanimit, certifikata e gjendjes familjare, certifikata e shtetësisë, certifikatë e gjendjes martesore dhe vërtetim nga arkivi	1 €
2	Aktvendimi për ndërrimin e emrit personal	10 €
3	Korigjimet e shënimeve në Regjistrat e Gjendjes Civile	2 €
4	Deklaratë për bashkësinë familjare	2 €
5	Ceremonia e kurorëzimit në Zyrën e Komunës	10 €
6	Ceremonia e kurorëzimit jashtë Zyrës së Komunës	80 €
7	Ceremonia e kurorëzimit me shtetasin e huaj	20 €
8	Regjistrimi i veçantë i kurorave (legalizimi i kurorave jashtë vendit)	10 €
9	Regjistrimi i veçantë i vdekjeve (legalizimi i vdekjeve të ndodhura jashtë vendit)	5 €
10	Regjistrimi i veçantë i fëmijëve të lindur jashtë vendit	7 €
11	Dëshmi vdekje	5 €
12	Deklaratë për mbajtës të familjes	4 €
13	Lëshimi i kopjeve të dokumenteve që i posedon Arkivi i qytetit, për çdo faqe	0.50 €
14	Certifikatë për lejimin e shtesave fëmijore e cila kërkohet jashtë	4 €

	vendit	
15	Pjesëmarrja në Ankand për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të tokës në pronësi të Komunës	20 €
16	Vërtetim i kopjes të dokumentit të arhivuar	10 €
17	Pjesëmarrja në Ankand për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës në pronësi të Komunës	100 €
18	Pjesëmarrja në Ankand për shitjen e mjeteve themelore	10 €
19	Aktvendimet tjera nëse me dispozita tjera dhe këtë Rregullore nuk është përcaktuar shumë tjetër e taksës	3 €
20	Pranimi dhe protokolimi i kërkesave nga fusha e planifikimit,urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit si dhe gjeodezisë dhe kadastrit.	2 €
21	Kopja e dokumenteve të arkivuar në kuadër të njësive organizative-drejtorateve komunale	5 €
22	Vërtetim për botën e jashtme për qëndrim në Kosovë për periodën e caktuar dhe paisje me patent shofer për banorët rezident të Komunës së Lipjanit	4 €

2. Nga pagesa e taksave nga paragrafi 1 i këtij neni në numrat rendor 1,2,3,4,5,12,13,14 dhe 19, janë të liruar: anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë ,invalidët dhe veteranët e luftës së UÇK-së, shfrytëzuesit e të drejtës të asistencës sociale dhe personat me aftësi të kufizuara të kategorizuar me vendim mjekësor.
3. Nga pagesa e taksës në numrin rendor 13 - Lëshimi i kopjeve të dokumenteve që i posedon Arkivi i qytetit, për çdo faqe të shkruar nga 0.50 €, janë të liruar pensionistët.
4. Lirimi nga pagesa e taksave nga paragrafi 2 i këtij neni bëhet në bazë të prezentimit të dokumentit përkatës të prezentuar nga parashtruesi i kërkesës.

Neni 7

Kërkesat dhe aktet zyrtare për të cilat nuk do të bëhet pagesa e taksës

1.Nuk do të aplikohet taksa për kërkesa dhe vendime, nëse me dispozita tjera nuk është përcaktuar ndryshe, si vijon:

- 1.1 për punësim dhe nga marrëdhënia e punës,
- 1.2 për njohjen e të drejtave nga asistencë sociale dhe ndihmë momentale sociale,
- 1.3 për trajtim shëndetësor,
- 1.4 për subvencione sipas Rregullores komunale për subvencionet,
- 1.5 vërtetime mbi pagesën e tatimit në pronë,
- 1.6 për parashtrësia dhe peticione lidhur me punën e organeve komunale,
- 1.7 për kundërshtime dhe ankesa sipas vendimeve të organeve komunale,
- 1.8 për kërkesa dhe vendime për kryerjen e praktikës profesionale
- 1.9 kërkesa dhe hulumtime shkencore dhe

1.10 për kërkesa dhe parashtrirat për ndërmarrjen e veprimeve të mbikëqyrjes inspektive.

1.11 për kërkesa dhe parashtrirat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për realizimin e aktiviteteve të ndryshme me karakter edukues, human apo të ngjashme për ndonjë ditë të caktuar.

Neni 8

Taksa për pronësinë e automjeteve motorike

1. Obligues të taksës për pronësinë e automjeteve motorike janë pronarët e automjeteve motorike: personat fizik të cilët janë banorë të Komunës, shoqëritë e regjistruara tregtare, dhe shoqatat joqeveritare që kanë selinë në Komunë.

2. Kjo taksë përcaktohet dhe paguhet në shumë vjetore me rastin e regjistrimit të automjeteve, si vijon:

Nr.	Lloji i automjetit	Taksa
1	Automjetet me peshë deri në 3.5 tonë	20 €
2	Automjetet me peshë mbi 3.5 tonë	30 €

3. Të liruar nga pagesa e kësaj takse për automjetet që i kanë në pronësi, janë:

Organizata e veteranëve të luftës të UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të luftës të UÇK-së, Shoqata e familjeve të dëshmorëve të luftës të UÇK-së, Kryqi i kuq Komunal, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë, invalidët e luftës së UÇK-së, veteranët luftëtar të UÇK-së dhe shoqatat për përkujdesje të personave me aftësi të kufizuara, paraplegjikët dhe personat me aftësi të kufizuara të kategorizuar me vendim mjekësor.

Neni 9

Taksa për vendosjen e objekteve lëvizëse në sipërfaqet publike

1. Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për dhënie të lejeve për shfrytëzim sezonal në kohëzgjatje jo më shumë se një vit të hapësirave publike në pronësi të Komunës për vendosjen e objekteve lëvizëse.

2. Lartësia e obligimit përcaktohet për kohëzgjatjen e shfrytëzimit të sipërfaqes publike e përcaktuar në lejen për shfrytëzim për objektet lëvizëse, si vijon :

Nr.	EMËRTIMI DHE VEPRIMTARIA	BAZA	SHUMA
1	Paisjet për shitjen e akulloreve, pijeve freskuese, duhanit, pofkave, misrit, gështenjave dhe të ngjajshme. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m ²	5 €

2	Shfrytëzimi i sipërfaqeve para objekteve të biznesit për veprimtarinë e cila është e lejuar të ushtrohet edhe jashtë objektit dhe për ekspozimin e mallrave të lejuara. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore.	m ²	2 €
3	Konstrukcionet për lojëra dhe të lunaparqeve. Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m ²	0.50 €
4	Tavolinat lëvizëse për shitjen e urimeve, panoramave dhe fotografive artistike, librave, bizhuterive, gjërave dekorative, mjeteve piroteknike CD- kasetave dhe të ngjashme Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m ²	3 €
5	Promovimi i produkteve të biznesit. Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m ²	1 €
6	Vendosja e reklamave para objekteve afariste në pronën e komunës. Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore.	m ²	50 €
7	Aparatet dhe skarat për përgaditjen e produkteve ushqimore, i cili së bashku me shtëpizën e aparatit, nuk kalon sipërfaqen prej 2m ² . Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m ²	10 €
8	Automjete lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë, automjet i veçantë i atestuar për kryerjen e veprimtarisë për shitjen e ushqimit të shpejtë. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m ²	20 €
9	Vendosja e muraleve në fasadat e ndërtesave . Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m ²	30 €
10.	Ekranet dhe reklamat elektronike. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m ²	50 €
11.	Vendosja e gjeneratorëve në sipërfaqen publike. Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	m ²	75 €
12.	Vendosja e kabinave telefonike.Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore.	m ²	100 €

3. Nga pagesa e taksës në numrin rendor 4- Tavolinat lëvizëse për shitjen e urimeve, panoramave dhe fotografive artistike, librave, bizhuterive, gjërave dekorative, mjeteve piroteknike CD-kasetave dhe të ngjashme, janë të liruar shitësit e librave.

4.Të liruar nga pagesa e taksës në numrin rendor 5 të paragrafit 2 të këtij neni – Promovimi i produkteve biznesit janë organizatat e ndryshme joqeveritare joprofitabile të cilat kanë parashtruar kërkesë pranë organeve kompetente komunale dhe i është lejuar promovimi i produkteve të tyre në formë panairi apo të ngjajshme për ndonjë ditë të caktuar.

M

5. Grupet e nxënësve, studentëve, institucionet publike, subjektet politike, OJQ-të e ndryshme dhe të ngjashme për ditë të caktuara për zhvillimin e ndonjë aktiviteti të karakterit edukativ, human, shëndetësor, politik dhe aktivitete tjera të ngjashme për vendosjen e ndonjë tavolinë, tabele informuese, tendë e të ngjashme nuk paguajnë taksë për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme.

Neni 10

Taksa për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve për Kulturë, Rini dhe Sport

1. Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport me rastin e parashtrimit të kërkesave të subjekteve të regjistruara për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të objekteve për Kulturë, Rini dhe Sport, si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shuma
1.	Shfrytëzimi i sallave, kinemavo dhe teatrove	30 € / h
2.	Shfrytëzimi i objekteve sportive të mbyllura (sallat)	100 € / h
3.	Shfrytëzimi i objekteve të kulturës	30 € / h
4.	Shfrytëzimi i objekteve sportive të hapura (Stadiumet)	100 € / h

2. Nga pagesa e taksave në numrat rendor 1,2,3 dhe 4 lirohen klubet e Komunës të cilat janë të kualifikuara dhe garojnë në ligat përkatëse sportive, OJQ-të e Lipjanit dhe individët rezident të Komunës së Lipjanit.

Neni 11

Taksa për ndarjen e rendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus

Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë ndarjes së rendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus dhe është 30€ për një rend të udhëtimit. Pagesa vlen për tri vite njëjtë sikur rendet e udhëtimit.

Neni 12

Taksa për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë auto-taksi

Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim me rastin kur operatori paiset me licencë për ushtrimin e veprimtarisë auto-taksi. Taksa është 30 € për një automjet.

Neni 13

Taksa për shfrytëzimin e parkingjeve për automjetet taksi

1. Taksën për shfrytëzimin e parkingjeve për automjetet taksi, janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e licencuar për veprimtarinë autotaksi, për secilin automjet në shumë vjetore në lartësi prej 30 €.

M

2. Pagesa e parë për vitin kalendarik do të bëhet me rastin e lëshimit të licencës për ushtrimin e veprimtarisë "taksi" dhe caktimin e autoparkimit për vendosjen e automjetit ndërsa për vitet tjera në vijim pagesa bëhet për secilin vit kalendarik.

3. Me gjobë në shumë prej 60 € do të dënohet ushtruesi i veprimtarisë autotaksi në rast të moskryerjes së pagesës së taksës së cekur në par. 1 të këtij neni pas pranimit të njoftimit e cila gjobë shqiptohet nga ana e inspektorëve komunal të trafikut .

Neni 14

Taksa për antena të telefonisë mobile dhe të internetit

1. Taksën për vendosjen e antenave të telefonisë mobile janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e veprimtarisë të telefonisë mobile për secilën antenë të vendosur në territorin e Komunës në bazë vjetore në lartësi prej 100 €.

2. Taksën për vendosjen e antenave të internetit janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e veprimtarisë të internetit për secilën antenë të vendosur në teritorin e Komunës në bazë vjetore në lartësi prej 50 €.

3. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e lëshon lejen për vendosjen e antenave të telefonisë mobile dhe atyre të internetit dhe e njofton Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim me një kopje të lejes së lëshuar .

4. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim ua përgatitë dhe lëshon faturat për pagesë për shfrytëzim të hapësirës publike ushtruesëve të veprimtarisë të telefonisë mobile dhe internetit në bazë të lejes së lëshuar për secilin vit kalendarik për antenat e telefonisë mobile dhe internetit të vendosura vetëm në pronën publike .

5. Ushtruesit e veprimtarisë të cekur në paragrafin 4 të këtij neni janë të obliguar të paguajnë taksën në lartësi prej 100 € për secilën antenë në bazë vjetore.

6. Subjektet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni do të dënohen me gjobë në rast të moskryerjes së pagesës së taksës të cekur në paragrafet 1,2 dhe 5 të këtij neni. Gjoha ose sanksioni kundërvajtës do ti shqiptohet deri në dyfishin e vlerës së taksës nëse kjo vlerë e gjobës nuk tejkalon limitet e përcaktuara me dispozitat e nenit 29 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje.

Neni 15

Taksa për përçojat e vendosura në pronën komunale

1. Këtë taksë janë të obliguar ta paguajnë subjektet e biznesit të cilët krijojnë të hyra nga ushtrimi i veprimtarisë duke vendosur përçojat e rrjetit kabllor, internet dhe telefonik në pajtim me lejen përkatëse për vendosjen e tyre të lëshuar nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

2. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e lëshon lejen për vendosje dhe e njofton Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim me një kopje të lejes së lëshuar.

3. Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ua përgatitë dhe lëshon faturat për pagesë për shfrytëzim të hapësirës publike ushtruesëve të veprimtarisë të cekur në paragrafin 1 të këtij neni në bazë të lejes së lëshuar për secilin vit kalendarik.

4. Ushtruesit e veprimtarisë të cekur në paragrafin 1 të këtij neni janë të obliguar të paguajnë taksën në lartësi prej 0.10 € për metër gjatësi në bazë vjetore.

5. Subjektet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni do të dënohen me gjobë në rast të vendosjes pa lejen e DPUMM-së ose në rast të moskryerjes së pagesës së taksës të cekur në paragrafet 1 dhe 4 të këtij neni. Gjoha ose sanksioni kundërvajtës do të shqiptohet deri në dyfishin e vlerës së taksës nëse kjo vlerë e gjobës nuk tejkalon limitet e përcaktuara me dispozitat e nenit 29 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje.

6. Për vendosjen e përçojave (kabllove) të energjisë elektrike, shërbimeve të ujësjellesit, kanalizimit dhe të ngjashme do të paguhet taksë vetëm me rastin e marrjes së lejes për vendosje ose shtrirje nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 16

Taksa për dhënien e pëlqimit për kyqje në rrugë publike

1. Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim me rastin e parashtrimit të kërkesave nga palët.

2. Lartësia e obligimit të pagesës përcaktohet si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shuma në euro
1.	Personat fizik – banim individual	30 €
2.	Personat juridik-biznese	120 €

Neni 17

Taksa për dhënien e pëlqimit për ndërprerje të përkohëshme të qarkullimit në rrugën publike

1. Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim me rastin e parashtrimit të kërkesave nga personat fizik ose juridik, si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shuma në euro (llogaritur me orë)
1.	Njëri shirit i rrugës	15 € ora
2.	Të dy shiritat e rrugës	20 € ora

M

2.Me rastin e dhënies së pëlqimit , Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim obligohet ta njoftojë Policinë dhe Inspektoratin Komunal për orën dhe vendin e saktë ku do të bllokohet ose ndërpritet përkohësisht qarkullimi në rrugë publike.

Neni 18

Taksa për dhënien e pëlqimit për shpim, prerje të rrugës publike dhe trotuarit me asfalt dhe kubëza

1.Kjo taksë aplikohet nga Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim me rastin e dhënies së pëlqimit për shpim, prerje të rrugës publike dhe asfaltit me rastin e riparimit të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik, telefonik e të ngjashme.

1.1. Lartësia e obligimit të pagesës për shpim të rrugës ose trotuarit, përcaktohet si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shuma në euro
1.	Personat fizik	10 € /m gjatësi
2.	Personat juridik	20 € / m gjatësi

1.2. Lartësia e obligimit të pagesës për prerje tërthore të rrugës, përcaktohet si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shuma në euro
1.	Personat fizik	30 € / m gjatësi
2.	Personat juridik	50 € / m gjatësi

1.3. Lartësia e obligimit të pagesës për prerje tërthore të trotuarit, përcaktohet si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shuma në euro
1.	Personat fizik	30 € / m gjatësi
2.	Personat juridik	50 € / m gjatësi

1.4. Lartësia e obligimit të pagesës për prerje gjatësore të rrugës dhe trotuarit, përcaktohet si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shuma në euro
1.	Personat fizik	2.5 € / m gjatësi
2.	Personat juridik	10 € / m gjatësi

Neni 19

Taksa për shfrytëzim të trotuarit për shkarkim të mallrave dhe gjësendeve tjera

- 1.Kjo taksë aplikohet nga Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim me rastin e dhënies së pëlqimit për shfrytëzimin e trotuarit për shkarkimin e mallrave dhe gjësendeve tjera.
- 2.Lejohet shfrytëzimi i trotuarit për shkarkimin e mallrave dhe gjësendeve tjera në maximum prej një ore. Pas kalimit të orës së caktuar duhet të lirohet trotuari duke e larguar mallin ose materialin nga trotuari.
- 3.Lartësia e taksës paguhet në vlerë prej 20 €

Neni 20

Taksë për shfrytëzimin e hapësirave publike rreth vendpunishteve

- 1.Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Shërbime publike me rastin e dhënies së pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirës publike rreth vendpunishteve e cila mund të kërkohet nga ana e personave fizik dhe juridik të cilët gjatë realizimit të punimeve në fushën e ndërtimitarisë ose ngjashme e kanë të domosdoshme shfrytëzimin e hapësirës publike rreth vendpunishtes.
2. Lartësia e taksës paguhet në vlerë prej 1€ për m² (në bazë mujore).

Neni 21

Taksë për shfrytëzimin e parkingut nëntokësorë

1. Këtë taksë janë të obliguar t'a paguajnë të gjithë shfrytëzuesit e parkingut nëntokësorë në qytetin e Lipjanit.
- 2.Vlera e pagesës së taksës për shfrytëzimin e parkingut nëntokësorë do të jetë :
 - 1-2 orë - 1 € , duke përjashtuar 15 minutat e hyrjes,
 - 2-4 orë - 2 € ,
 - mbi 4 orë - 3 € por jo më shumë se 12 orë brenda ditës.
3. Kushtet, kriteret dhe lirimi nga pagesa e taksës së përcaktuar me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni do të rregullohen me akt të veçantë nga Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 22

Taksat për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për rastet e veçanta për realizimin e investimeve në sektorin e energjisë

- 1.Këto taksa aplikohen për pronat komunale që ipen në shfrytëzim me vendime të Kuvendit të Komunës, konform dispozitave të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj, për

rastet e veçanta për realizimin e investimeve në sektorin e energjisë dhe përcaktohen si vijon:

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË TAKSËS	BAZA	SHUMA
1.	Shfrytëzimi i pronës komuanale në ZK Lipjan për qytetin e Lipjanit për investime në sektorin e energjisë, Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	Sipërfaqe nga 1m ² deri në 10m ²	100 €
2.	Shfrytëzimi i pronës komuanale në ZK Lipjan për qytetin e Lipjanit për investime në sektorin e energjisë, Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	Sipërfaqe mbi 10m ²	150 €
3.	Shfrytëzimi i pronës komuanale në Zonat Kadastrale (fshatrat e Komunës së Lipjanit) për investime në sektorin e energjisë, Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	Sipërfaqe nga 1m ² deri në 10m ²	40 €
4.	Shfrytëzimi i pronës komuanale në Zonat Kadastrale (fshatrat e Komunës së Lipjanit) për investime në sektorin e energjisë, Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	Sipërfaqe mbi 10m ²	80 €

Neni 23

Taksat për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës (përcaktimi i qirasë).

1.Këto taksa aplikohen për pronat komunale që ipen në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë me vendime të Kuvendit të Komunës, konform dispozitave të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, Ligjit për parqet industriale dhe teknologjike dhe akteve nënllogjore që derivojnë nga këto ligje.

2.Në tabelën vijuese përcaktohet lartësia e qirasë përkatësisht çmimi fillestar i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim- me destinim të shfrytëzimit për toka bujqësore (ankand publik), sipas klasëve të bonitetit të tokës – në baza vjetore :

Nr.	Boniteti-kuliteti i klasës së tokës bujqësore	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
1	Lartësia e qmimit për 1ha	60€	55€	50€	45€	40€	35€	30€	25€

M

3. Në tabelën vijuese përcaktohet lartësia e qirasë përkatësisht çmimi fillestar i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim- me destinim të shfrytëzimit për kullosë (ankand publik), sipas klasëve të bonitetit të tokës – në baza vjetore

Nr.	Boniteti-kuliteti i klasës së tokës për kullosë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
1	Lartësia e qmimit për 1ha	50€	45€	40€	35€	30€	25€	20€	10€

4. Në tabelën vijuese përcaktohet lartësia e qirasë përkatësisht çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim të lokaleve afarsite me destinim të shfrytëzimit për ushtrimin e aktiviteteve të biznesit (ankand publik),– në baza mujore

Nr.	Emërtimi	Zona - Vendndodhja		
		Zona e I-rë –Çmimi /m ²	Zona e II-rë –Çmimi /m ²	Zona e III-rë –Çmimi /m ²
1	Lokali afarist	4€	3€	2€

5. Në tabelën vijuese përcaktohet lartësia e qirasë përkatësisht çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës me destinim të shfrytëzimit për ushtrimin e aktiviteteve të biznesit (ankand publik),– në baza mujore, sipas tabelës në vijim;

Nr.	Emërtimi	Zona - Vendndodhja					
		Zona e I-rë –Çmimi /m ²		Zona e II-rë –Çmimi /m ²		Zona e III-rë –Çmimi /m ²	
1	Prona e paluajtshme e komunës	Prej 1 m ² deri në 30 m ²	Prej 30 m ² deri në 100 m ²	Prej 1 m ² deri në 30 m ²	Prej 30 m ² deri në 100 m ²	Prej 1 m ² deri në 30 m ²	Prej 30 m ² deri në 100 m ²
		160 €	220 €	80 €	120 €	60 €	80 €

6. Në tabelën vijuese përcaktohet lartësia e qirasë, për subjektet e biznesit të cilat kanë ofertuar përmes konkursit publik për marrjen në shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës- me destinim të shfrytëzimit për ushtrimin e aktiviteteve të biznesit, Lartësia e qirasë përcaktohet në baza vjetore ku në tri (3) vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën nuk do të paguajnë kompensimin, ndërsa pas tri viteve do të paguajnë sipas tabelës në vijim;

M

Zona Kadastrale - Konjuh

<i>Nr.</i>	<i>Kohëzgjatja e shfrytëzimit</i>	<i>Çmimi për m²-baza vjetore</i>	<i>Çmimi për 1Ha-baza vjetore</i>
1	Në tri (3) vitet e para	0.00€	0.00€
2	Prej vitit katërt (4) deri vitin e shtatë (7)	0.10 €	1,000.00€
3	Prej vitit tetë (8)deri vitin e dhjetë (10)	0.14€	1,400.00€
4	Prej vitit njëmbëdhjetë (11) e tutje	0,15€	1,500.00€

Zona Ekonomike - Qylagë

<i>Nr.</i>	<i>Kohëzgjatja e shfrytëzimit</i>	<i>Çmimi për m²-baza vjetore</i>	<i>Çmimi për 1Ha-baza vjetore</i>
1	Në tri (3) vitet e para	0.00€	0.00€
2	Prej vitit katërt (4) deri vitin e shtatë (7)	0.07€	700.00€
3	Prej vitit tetë (8)deri vitin e dhjetë (10)	0.11€	1,100.00€
4	Prej vitit njëmbëdhjetë (11) e tutje	0,12.5€	1,250.00€

Zona Kadastrale – Babush i Muhaxherëve dhe Zona tjera kadastrale

<i>Nr.</i>	<i>Kohëzgjatja e shfrytëzimit</i>	<i>Çmimi për m²-baza vjetore</i>	<i>Çmimi për 1Ha-baza vjetore</i>
1	Në tri (3) vitet e para	0.00€	0.00€
2	Prej vitit katërt (4) deri vitin e shtatë (7)	0.05 €	500.00€
3	Prej vitit tetë (8)deri vitin e dhjetë (10)	0.09 €	900.00€
4	Prej vitit njëmbëdhjetë (11) e tutje	0,11 €	1,100.00€

7. Taksat e përcaktuara me dispozitat e paragrafëve paraparak të këtij neni do të aplikohen për pronat komunale që ipen në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

M

III. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 24

Detyrat e organeve dhe institucioneve të Komunës

Organet e administratës dhe institucionet e Komunës, sipas fushëveprimtarisë së tyre, janë të obliguara të zbatojnë dhe të inkasojnë taksat nga personat fizik dhe juridik sipas procedurave të përcaktuara me këtë Rregullore.

Neni 25

Detyrat e obliguesve

Obliguesit kanë për detyrë të paguajnë shumat e caktuara të taksave sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara me këtë Rregullore.

IV. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 26

Kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa

Pala e pakënaqur me aktin e Organit të Komunës kompetent për shqyrtimin e kërkesës, me të cilin i përcaktohet shuma e obligimit për pagesë të taksës, mund të parashtojë kërkesë për rishqyrtim sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative .

V. MBIKQYRJA DHE ZBATIMI

Neni 27

Mbikqyrja dhe zbatimi

Për mbikqyrjen dhe zbatimin e kësaj e Rregulloreje do të kujdeset Drejtorati për Inspeksion , Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Sektori pronësor juridik dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 28

Autorizimet e Inspektorëve

Inspektorët përkatës komunalë janë të autorizuar të mbikqyrin zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje .

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 29

Hyrja në fuqi

- 1.Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Taksat Komunale Nr.15-353-35821 e datës 30.06.2021.
- 3.Në rast kontesti mes dispozitave ligjore dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje kanë përparësi dispozitat e Ligjit dhe Udhëzimeve administrative të nivelit qëndror

Arsyetimi

Baza ligjore për propozimin dhe miratimin e kësaj Rregulloreje është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Statutit të Komunës së Lipjanit.

Në Rregulloren për Taksa dhe Gjoba komunale përcaktohen vetëm taksat të cilat në harmoni me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal janë në kompetencë të Komunës për ti përcaktuar, ndërsa taksat që janë të përcaktuara me Ligje dhe Udhëzime Administrative nuk i ka përfshirë pasi zbatohen drejtëpërdrejtë dispozitat e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative pasi nuk është konsideruar e arsyeshme të përsëriten dispozitat ligjore.

Me vendim të Kryetarit të Komunës është themeluar grupi punues për hartimin e Draft Rregullores për Taksa Komunale .

Kjo Propozim- Rregullore i është nënshtruar procedurave të konsultimit publik dhe është mbajtur debati publik në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e kësaj Propozim-Rregulloreje

1Nr. 434/01-17885

Lipjan , më 20.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

